



| | | | |
|---|--------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Doretuar Prilbjen/Prodato Received/Delivery | 27-12-2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Jednica Org./Unit | Pr Prot Pr Prot | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKDMSHCK 7677/2023 | | | 116 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.492/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi -Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj -Demi-anëtar si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me A.nr.1776/2021 të datës 03.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të Korrigjuar sipas Aktvendimit të datës 06.11.2023 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.42/2020 të datës 21.02.2020 e parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga:

kundër organit të punësimit Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.42/2020 e datës 21.02.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi KZKA/03/2020 i datës 18.02.2020 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Vendimi me Nr. Port: 35/19 i datës 27.12.2019 i Udhëheqësit Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

A r s y e t i m

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore më datë 18.05.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm-avancim për vendin e punës "*Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme*" me numër të referencës RN00004888 pas marrjes së autorizimit për publikimin e konkursit të datës 17.05.2019 nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil.

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e datës 18.05.2019 për vendin e punës "*Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme*" me numër të 1/5 referencës RN00004888 e cila pas

përfundimit të procedurave të rekrutimit emërohet në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme" me çka i bëhet edhe ndryshim dhe plotësimi i akt emërimit më datë 01.07.2019.

Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me datë 27.12.2019 merr Vendimi me Nr.Prot: 34/19 me të cilin vendim shfuqizohet plotësimi dhe ndryshimi i akt emërimit të datës 01.07.2019, anulohet procedura e konkursit të brendshëm-avancim i shpallur me datë 18.05.2019 si dhe ankuesja kthehet në pozitën e punës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt emërimit të datës 09.03.2018 "Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim dhe Marrëdhënie me Publikun".

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me Nr.Prot: 34/19 të datës 27.12.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me datë 20.01.2020 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 01/20 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me datë 18.02.2020 nxjerr Vendim me KZKA/03/2020 me të cilin vendim hedhet poshtë ankesa e ushtruar nga ankuesja. Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër KZKA/03/2020 të datës 18.02.2020 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me datë 20.02.2020 nëpërmjet e-mailit zyrtarë parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila ankesë regjistrohet me date 21.02.2020 me numër të protokollit 405/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.02.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 09.03.2020 ka përcjell përgjigjen në ankesë me dokumentacionin e bashkangjitur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 09.03.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar ankuesen që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 28.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.699/2020 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 09.03.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankueses të datës 21.02.2020.

Këshilli i pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës me datën 08.07.2021 ka njoftuar Gjykatën se përsëri Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk ka kuorum për te vendosur lidhur me ankesën e ankueses. Ndërsa kjo e fundit ka vazhduar tutje me iniciimin e procedurës në Gjykatën Themelore ne Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.07.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1776/2021 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e datës 08.07.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankueses të datës 02.06.2021, ndërsa me date 06.11.2023 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerr Aktvendim përmes se cilit ka korrigjuar Aktgjykimin me numër A.nr.1776/2021 lidhur me datën e ankesës se vendosjes ne KPMSHCK që është korrigjuar nga data 02.06.2021 me datën 20.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin e vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktvendimin e datës 06.11.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative për korrigjimin e Aktgjykimit me numër A.nr.1776/2021 të datës 12.07.2023; Aktgjykimin me numër A.nr.1776/2021 të datës 12.07.2023 të Gjykatës Themelore ne Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Emalin e datës 15.07.2021 të drejtuar Emalin e datës 14.07.2023 drejtuar Emalin e datës 13.07.2023 të drejtuar Kërkesën e datës 13.07.2021 te parashtruar nga ankuesja ne Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.01.2020; Njoftimin e datës 08.07.2021 të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës; Njoftimin e datës 08.07.2023 te Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës; Aktgjykimi A.nr.699/2020 i datës 28.05.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ; Kërkesa c datës 10.07.2020 e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankueses e datës 21.02.2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 18.02.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Ankesa e ankueses e datës 20.01.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Vendimi i datës 27.12.2019 i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt emërimit të ankueses i datës 01.07.2019; Formulari për pranimin e dokumentacionit për Nr.01/19; Kërkesa për punësim e Kopja e letërnjoftimit e ankueses Diploma e lëshuar nga UBT e datës 20.10.2016; Diplomë e lëshuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji e datës 04.11.2013 për studimet Master; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 09.03.2018; Autorizimi i datës 17.05.2019 për publikimin e konkursit; Shpallja e konkursit të brendshëm i datës 18.05.2019 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses, *është e pazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk ka arritur të konstatoj dejtë gjendjen faktike pasi ka vendosur në kundërshtim me dispozitat përkatëse sepse nuk ka arritur të zgjidh kontestin respektivisht nuk ka arritur të gjeje zgjedhje përmes kompromisit; po ashtu e njëjta pretendon se Vendimi i datës 27.12.2019 i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i kundërligjshëm ngase ajo pretendon se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike pasi që e njëjta e ka përgatitjen profesionale gjegjësisht kualifikimin e kërkuar sepse posedon Diplome të Masterit në drejtimin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, si dhe përvojën e punës të kërkuar sipas konkursit.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesja, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme", të shpallur me datë 18.05.2019 nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civile dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi ka marrë autorizimin nga Ministria e Administratës Publike DASHC/MAP me datën 17.05.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se në konkursin e brendshëm-avancim të shpallur më datë 18.05.2019 për vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme", kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplomë universitare e preferuar në: Menaxhment Biznesi, Ekonomi, Teknologji Informative;*
- *Minimumi 5 vite përvojë pune etj.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të dërguara nga organi i punësimit dhe nga ankuesja ka konstatuar se, ankuesja me rastin e aplikimit dhe plotësimit të formularit për pranimin e dokumentacionit me numër 01/19 të datës 23.05.2019 dhe kërkesës për punësim në fushën e shkollimit e ka të plotësuar se ka përfunduar *Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë në vitin 1998, Masterin në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT në vitin 2013, Bachelorin në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT në vitin 2016, Masterin vazhdon në UBT në Sistem të Informacionit dhe Specializim në vitin 2014 në Chiba Prefecture në Japoni.*

Sipas Vendimi me Nr. Prot: 35/19 të datës 27.12.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është bërë shfuqizimi i plotësim/ndryshimit të aktit të emërimit të datës 01.07.2019 dhe anulimin e procedurës së konkursit të brendshëm për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme", Kolegji i Këshillit, konstaton se shfuqizimi i plotësim/ndryshimit të aktit të emërimit të datës 01.07.2019 dhe anulimi i konkursit të brendshme për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme", është bërë me arsyetimin se pala ankuese si kandidatë e suksesshme nuk ka ofruar dëshmi të përgatitjes profesionale/diplomë të studimeve të nivelit të parë bachelor para vitit 2016.

Nga vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit me Nr. Prot: 35/19 të datës 27.12.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin e brendshëm për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme", nuk është kërkuar që niveli i studimeve të jetë i nivelit Master, por mbi bazën e konkursit niveli i kualifikimeve profesionale kërkohet të jetë në nivelin e parë të studimeve respektivisht studimet themelore Bachelor dhe po ashtu në fushat dhe drejtimet përkatëse të kërkuar me konkurs. Në bazë të provave të lëndës, ankuesja me rastin e aplikimit sipas kërkesës për punësim ka deklaruar se në vitin 1998 ka përfunduar Shkollën e Lartë Teknike në Mitrovicë mirëpo e njëjta nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të tillë me rastin e aplikimit, ndërsa si dokumente të përgatitjes profesionale gjegjesisht kualifikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr. 118/45-65 të datës 04.11.2013 të lëshuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji- UBT me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet postdiplomike Master në programin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, me date 10.09.2013 ku ka fituar gradën Master Profesional në Menaxhment dhe Biznes dhe Ekonomi si dhe Diplomën me Nr. 177/45-64 të datës 22.10.2016 të lëshuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji- UBT, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në programin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, me date 20.10.2016 dhe ka fituar gradën Bachelor i Shkencave

Kompjuterike dhe Inxhinieri, me specializim ne Softuer dhe Sisteme Inxhinierie, ndërsa si dëshmi për përvojë punë ankuesja ka dorëzuar Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt emërimit të datës 09.03.2018 ne pozitën "Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim dhe Marrëdhënie me Publikun". Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë këtyre dokumenteve të ofruara ka konstatuar se ankuesja nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale pas diplomimit prej pesë (5) vite përvojë pune ashtu siç është kërkuar në konkurs sepse në bazë të dokumentacionit të dërguar nga ankuesja dhe organi i punësimit Kolegji i Këshillit konstaton se përvoja e punës për pozitën përkatëse llogaritet vetëm ajo përvojë e punës e fituar pas diplomimit në fushën në të cilën kërkohet sipas konkursit e që nënkupton se përvoja e punës në rastin e ankueses konsiderohet përvojë punë vetëm ajo e fituar pas diplomimit gëgjësisht sipas Diplomës me Nr. 177/45064 të datës 22.10.2016 të lëshuar nga UBT për përfundimin e studimeve themelore me date 20.10.2016 ku ka fituar titullin Baçelor i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Andaj sa i përket vlerësimit të përvojës së punës pas diplomimit, Këshilli i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjytimeve konstatohet se për pozitën profesionale dhe menaxheriale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit,

Bazuar në vlerësimin e kësaj çështje, Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se ankuesja nuk ka plotësuar kriteret e këtij konkursi gëgjësisht nuk e ka përvojën e punës pas diplomimit të kërkuar në raport me përgatitjen profesionale, dhe si rrjedhojë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e shqyrtimit të aplikacionit të ankueses nuk ka marr për bazë faktet konkrete dhe vendimtare respektivisht me rastin e përfshirjes së ankueses ne listën e shkurtë si dhe rekomandimin si kandidatë të suksesshme, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, dhe nenin 2, 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *1. „Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim:..., 1.2. përvojën e punës”, 2. Secili anëtar vlerëson kandidatin në se cilin kriter. Numri maksimal i se cilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura te tjera është 40 pikë. 3. Kandidatet të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes”.*

Andaj, duke marr për bazë konstatimin si më lartë, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar që Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor me rastin e marrjes së Vendimit me Nr. Port: 35/19 të datës 27.12.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse kjo procedurë e avancimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i palës ankuese ndaj këtij vendimi është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankueses ndaj Vendimit KZKA/03/2020 të datës 18.02.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kolegji i Këshillit, konstaton se neni 6 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave që i referohet aktpajtitimit i referohet duke u bazuar në nenin 52 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, mirëpo në kohën kur është zhvilluar kjo procedurë Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative nuk ka qenë në fuqi dhe nuk mund

të aplikohet kjo dispozitë, rrjedhimisht nuk mund të zbatohet kjo normë, kështu Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me rastin e marrjes së Vendimit me KZKA/03/2020 të datës 18.02.2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka arritur të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.492/2021

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Gjyqtares Lirije Maksutaj, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillin të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.